



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Politikën e Jashtme*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.04.2022, ora 11:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian Horizont Europa-programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin” (*Komision për dhënie mendimi*)

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016” (*Komision për dhënie mendimi*)

3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale” (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Tritan Shehu, Etilda Gjonaj, Ilirjan Pendavinji, Klodiana Spahiu, Blendi Klosi, Vangjel Dule, Grida Duma dhe Belind Këlliçi.

#### **Mungojnë:**

Shpëtim Idrizi, Greta Bardeli, Kreshnik Çollaku dhe Pandeli Majko.

#### **Të ftuar:**

Albana Tole – Zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit.

Mirela Muça – Drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Florian Nurçe – Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Voltisa Koçi – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Programit Standardizimit dhe harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Enkelejda Muçaj – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Irena Malolli – Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Adea Pirdeni – Zëvendësministre e Drejtësisë.

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 20.04.2022.

Sot në rendin e ditës kemi tri çështje.

Si pikë të parë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian Horizont Europa-programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe referon zoti Xhafaj.

Më pas kemi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe referon kolegu Krashi.

Në fund kemi projektligjin “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe referon sërish kolegu Xhafaj.

Për pikën e parë kemi të ftuara zonjat Albana Tole, zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit, dhe Mirela Muça, drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Mirë se vini, zonja të nderuara!

Pa humbur kohë, ju lutem, dy fjalë rreth marrëveshjes.

Fjala për ju, zonja zëvendësministre.

**Albana Tole** – Faleminderit, zonja kryetare!

Përsëritje të gjithëve!

Atëherë, në lidhje me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian”, duhet thënë se ky projektligj ka si qëllim përcaktimin e kriterëve dhe kushteve që duhet të përmbushen nga ana e Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrje në programin e Bashkimit Europian Horizont Europa, pra në programin kuadër për kërkimin shkencor dhe inovacionin.

Ky program riparaqitet nga ana e Komisionit Europian çdo 7 vjet, i cili shpall programin kuadër për kërkimin shkencor dhe inovacion.

Objektiv i këtij programi është të financojë projekte kërkimore, të cilat prezantohen nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë qoftë publike, qoftë jopublike, në mënyrë që të

financojë projektet kërkimore me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, të cilat, njëkohësisht, gjenerojnë edhe vende pune.

Bashkimi European synon të krijojë një treg të vetëm për kërkimin dhe inovacionin, duke nxitur dhe lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe duke zhvilluar një karrierë kërkimore në mbarë Europën nëpërmjet lehtësimit të lëvizshmërisë dhe të bashkëpunimit.

Nëpërmjet këtij programi Republika e Shqipërisë, pra Ministria e Arsimit dhe Sportit, i paguan Bashkimit European një kuotë anëtarësie vjetore nëpërmjet së cilës bëhet e mundur që institucionet e arsimit të lartë të kryejnë kërkim shkencor, që institucionet kërkimore-shkencore shqiptare të mund të aplikojnë për të përthithur fonde nga Bashkimi European në projektet e tyre kërkimore.

Një nga problematikat e kësaj marrëveshjeje është kontributi financiar, i cili paguhet nga qeveria shqiptare. Pra, do të duhet që ky financim në vetvete të justifikohet nëpërmjet një pjesëmarrjeje më të shtuar nga ana e institucioneve të arsimit të lartë, në mënyrë që të përthithet një numër fondesh më i lartë dhe të justifikohet kontributi i paguar nga ana e qeverisë.

Pjesëmarrja në këtë program kuadër është kusht për integrimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, i paraqitur në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”. Shqipëria ka qenë pjesë e programeve të mëparshme kuadër, si ai FP 7, i cili është realizuar nga viti 2007 deri në vitin 2013, dhe programi Horizon 2020, që është realizuar nga viti 2014 deri në vitin 2020.

Duhet thënë se në programet e mëparshme, në rastin konkret në FP 7-ën për periudhën 2007-2013, numri i projekteve ka qenë 245, numri në total i aplikimeve dhe numri në total i projekteve të fituara ka qenë 27, si dhe kontributi financiar i përfituar ka qenë 2 milionë euro. Ndërsa për programin Horizont 2020, i cili është zhvilluar në harkun kohor 2014-2020, numri total i aplikimeve ka qenë 605, numri në total i projekteve të fituara 52 dhe kontributi financiar i përfituar 5519546 euro. Pra, rezultatet e Shqipërisë, nëse do të duhet të bëjmë një krahasim ndërmjet programit FP 7 dhe Horizont 2020, kanë ardhur gjithnjë e më shumë në rritje dhe tarifa e përfituar është më shumë se e dyfishuar, nga 2 milionë euro në 5519546 euro.

Këtu vlen të theksohet fakti që në vitin e fundit, 2021, kemi informacion që subjekte nga Shqipëria kanë fituar projekte në cilësinë e liderit dhe kjo ndodh për herë të parë, ndërsa në programet e mëparshme pjesëmarrja nga ana e institucioneve tona ka qenë në kushtet e

pjesëmarrjes në një konsorcium, pra në një përbërje më të madhe institucionesh, ku ato lider kanë qenë institucionet pjesë e Bashkimit European.

Në rastin konkret jemi besimplotë që financimi i këtij programi do të mund të justifikohet nëpërmjet pjesëmarrjes më të gjerë nga ana e institucioneve tona të arsimit të lartë, pasi, edhe në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit, numri i bashkëpunimeve ndërmjet institucioneve të arsimit vendas dhe të huaja ka ardhur gjithnjë e më shumë në rritje. Në të njëjtën kohë edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit po punon për ngritjen e kapaciteteve, në mënyrë që të rritet mundësia e përfitimit të fondeve nga pjesëmarrja në këto projekte.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Ju falënderoj, zonja zëvendësministre!

Zonja Muça, keni diçka për të shtuar apo mund të vazhdojmë me relatorin?

**Mirela Muça** – Jo, thjesht jemi besimplotë që do të trefishohet, do të katërfishohet shuma, e cila do të disbursohet për fondet e kërkimit në shtatëvjeçarin ku jemi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Të relatojë kolegu Xhafaj dhe pastaj do të kalojmë në diskutime ose pyetje nga kolegët.

Etjen, fjala për ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Etjen Xhafaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zëvendësministre!

Të nderuar kolegë,

Programi “Horizont Europë” është, në fakt, programi çelës i Bashkimit European për kërkimin dhe zhvillimin, pra për kërkimin dhe inovacionin, me një shumë totale prej 95,5 miliardë eurosh, i cili merret me një sërë problematikash, që kanë të bëjnë qoftë me ato që janë ndryshimet e mëdha globale, qoftë me adaptimin e ekonomive të vendeve të Bashkimit European dhe të vendeve të tjera, të cilët janë kandidatë për anëtarë në Bashkimin European.

Synimi kryesor është krijimi dhe shpërndarja qoftë e njohurive, qoftë e teknologjive dhe, së dyti, sigurisht ka një fokus të veçantë mbi rininë dhe krijimin e vendeve të punës për të rinjtë. Rrjedhimisht, besoj se kjo është një nga ato arsytet më tepër, duke qenë se vjen edhe në vijim të programeve të vazhdueshme të të gjitha qeverive, në fakt, për *braingain* dhe *circulation*, pra për tërheqjen dhe kthimin e trurit, por gjithashtu për qarkullimin e tij brenda rajoneve të ndryshme të Shqipërisë. Kështu që ky është një program tejet i rëndësishëm.

Në fakt, unë do të thosha që, madje, jemi pak të vonuar për ta kaluar këtë, duke qenë se të gjitha vendet e tjera, qoftë edhe në rajon, e kanë bërë tashmë.

Duke mos dashur të ndalem në disa nga aspektet teknike, të cilat janë të përfshira qoftë në relacion, qoftë edhe vetë në projektligj, do të doja të sillja para të gjithëve ju, sidomos para përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nevojën që këtë herë, duke qenë se kur ka kaluar programi *Horizont 2020*, ka kaluar përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, një nga problematikat kryesore asokohe në vitin 2014 e në vijim ka qenë aftësimi qoftë i organizatave joqeveritare, qoftë i atyre jofitimprurëse për të aplikuar për projekte. Në këtë drejtim besoj se ne kemi shumë për të bërë dhe, rrjedhimisht, do të duhet t'i pararendim edhe ratifikimit, por edhe paraqitjes së kushteve teknike, duke qenë se vitin e parë të zbatimit të këtij programi nga Bashkimi European do të ketë vetëm një thirrje. Pra, do të doja të kishim qoftë një pararendje në trajnimin e të rinjve, po edhe të organizatave për të aplikuar, duke qenë se, në krahasim me vendet e rajonit, ne kemi qenë gjithmonë dhe historikisht në ritme më të ngadalta sesa të gjitha vendet e tjera.

Për sa i përket të gjithë pjesës tjetër, duke mirëkuptuar ato që janë pozicionet politike të të dyja krahëve, unë do të doja t'ju bëja thirrje ta kalojmë njëzëri dhe pa ndonjë debat të madh këtë program, duke qenë se në thelb është një program i mirë, sidomos për të rinjtë dhe për ato problematikat kryesore që kemi ne, pra për mbulimin e një sektori të tërë që ka të bëjë me inovacionin, i cili, pavarësisht të gjitha atyre politikave që janë duke u zhvilluar nga ana e qeverisë dhe që janë kaluar nga ky parlament, qoftë për sa i përket ligjit të *start up*-eve, qoftë sa i përket ligjit për nomadët dixhitalë apo edhe legjislacionit të tanishëm për përfshirjen e kurrikulave të inovacionit në arsimin edhe fillor, edhe primar, do të doja që, duke e parë të gjithën në një suazë të gjerë dhe si pjesë e një makinerie të madhe që do të duhet ta vëmë të gjitha palët në funksion për të aftësuar të rinjtë tanë të përballen me tregun e punës dhe me sfidat që i presin ata në momentin që përballen me tregun e punës, ftoj të gjithë kolegët ta miratojmë njëzëri.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Xhafaj!

Hapim diskutimet ose seancën e pyetjeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Tritan Shehu** – Faleminderit!

Padyshim unë e konsideroj pozitiv këtë dokument që ka ardhur, sepse është i rëndësishëm inovacioni. Kërkimi shkencor është një nga problemet e mëdha që kemi në arsimin e lartë, në institucionet tona kudo në Shqipëri dhe, të them të drejtën, është e kuptueshme. Nuk është se duhet ta marrim në mënyrë kaq tragjike, sepse edhe mundësitë dhe

dimensionet e vendit tonë, eksperiencia në këtë fushë nuk është... Domethënë, është e vështirë që ne të jemi të barasvendosur, në krahasim me vendet e tjera lidhur me kërkimin shkencor.

Megjithatë, ne duhet të bëjmë maksimumin, veçanërisht në aplikimin e arritjeve shkencore, arritjeve teknike të vendeve të tjera në vendin tonë, ku këtu shkollat tona të larta, institucionet tona mund të luajnë një rol të rëndësishëm që vlen edhe në përgatitjen e atyre që do të diplomohen, për t'u ballafaquar me nivele më të larta teknike në të ardhmen.

Pra, unë e konsideroj pozitive dhe të them të drejtën e votoj pozitivisht pa asnjë diskutim këtë material, në mënyrë kategorike. Por dua të them diçka. Kërkimi shkencor, kërkimi eksperimental është një fjalë e shenjtë, është një fjalë e madhe dhe nuk duhet ta keqpërdorim. Shpeshherë ne e keqpërdorim këtë gjë.

Ku e kam fjalën? E kam fjalën te një zhvillim i fundit që mua më ka krijuar, me gjithë mend, më ka lënë një shije shumë të keqe dhe si një paralajmërim për një rrezik për shoqërinë shqiptare. E kam fjalën për atë që është thënë se, pasi u bë një pyetësor, u pyet populli në tërësi dhe njerëzit vendosën të legalizojnë kanabisin mjekësor. Kupton? Ky më duket një sharlatanizëm i plotë shkencor, sepse këtu kemi të bëjmë me kërkime shkencore që bëhen në vende të fuqishme, madje edhe vende të tjera, si Italia, e kryejnë në nivele krejt minimale në një kohë kur njerëzit në Shqipëri vendoskan nëpërmjet një pyetësoi që të legalizohet kanabisi mjekësor, që, në fakt, është ende shumë larg implementimit klinik dhe tregut të vërtetë klinik.

Pra, unë jam dakord pikërisht që ne duhet t'u bashkëngjitemi të tilla nismave që të na fusin në rrugën e një kërkimi shkencor, korrekt, normal, jospekulativ dhe jopopulist.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Shehu!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka diskutim tjetër? Ka pyetje?

Mirë, unë e falënderoj kolegun Xhafaj për diskutimin shterues që bëri si relator, si dhe zonjat për prezantimin dinjitoz!

Kështu, nëse nuk kemi pyetje apo komente të tjera, mendoj ta hedhim në votim në parim. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

E hedhim në votim nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit, kolegë, për bashkëpunimin!

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Edhe një herë, në tërësi, ju lutem, kërkoj votën tuaj.

*(Deputetët e pranishëm shprehen dakord.)*

Ju falënderoj për bashkëpunimin!

Kolegë të nderuar, miq të vjetër, shumë faleminderit për prezencën!

Punë të mbarë! Shihemi në marrëveshje të tjera.

Faleminderit!





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 20.04.2022, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016”  
*(Komision për dhënie mendimi)*

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Tritan Shehu, Etilda Gjonaj, Ilirjan Pendavinji, Klodiana Spahiu, Blendi Klosi, Vangjel Dule, Grida Duma dhe Belind Këlliçi.

**Mungojnë:**

Shpëtim Idrizi, Greta Bardeli, Kreshnik Çollaku dhe Pandeli Majko.

**Të ftuar:**

Enkelejda Muçaj – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Irena Malolli – Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

**Mimi Kodheli** – Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016”.

Të ftuara kemi zonjën Muçaj, zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe zonjën Malolli, drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Dy fjalë, zonja zëvendësministre, rreth aderimit të Shqipërisë në këtë dokument të rëndësishëm.

Fjala për ju.

Faleminderit!

**Enkelejda Muçaj** – Fort e nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Politikën e Jashtme,

Ju falënderojmë shumë për mundësinë që na dhatë për të prezantuar, si Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë, në fakt si ministria përgjegjëse në sektorin e shërbimit postar në Republikën e Shqipërisë, projektligjin në fjalë, i cili ka në objektin e tij aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktet dhe dokumentet e Kongresit të 26-të të Bashkimit të Përbotshëm Postar, Stamboll 2016.

Ky detyrim lind nga neni 25 i kushtetutës së kësaj organizate, e cila është një nga agjencitë e Organizatës së Kombeve të Përbashkuara dhe që në vetvete përbëhet nga gjashtë dokumente kryesore: kushtetuta e Bashkimit të Përbotshëm, konventa e përbotshme postare, marrëveshja e shërbimeve të pagesave postare, rregullat e procedurës së kongreseve dhe rregullorja e përgjithshme të Bashkimit të Përbotshëm Postar.

Në fakt, miratimi vjen si pasojë e një detyrimi të marrë nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet një akti të brendshëm, me ligjin e vitit 1998, i cili jo vetëm detyron në njëfarë mënyre pjesën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në këtë organizatë, por merr përsipër edhe të gjitha detyrimet që lindin nga aktet e depozituara dhe të hartuara nga vendet anëtare, të cilat sot janë 192.

Vetëm për efektin e kontekstit historik, një javë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, kjo e fundit aderoi dhe u shpall anëtare e kësaj organizate, duke përbërë, në fakt, një nga shërbimet bazë, nga më themeloret dhe ndoshta nga më inicialet në të cilat shteti shqiptar, si një shtet i pavarur, në fakt, njihej edhe në arenën ndërkombëtare. Organizata është themeluar në 1874, të themi, disa vite më pas Organizatës Ndërkombëtare të Telekomunikacioneve.

Në këtë kuptim, ministria ka kënaqësinë të paraqesë para jush ndryshimet kryesisht në këto akte. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndryshimet në standardet e aplikuar nga vendet anëtare në lidhje me shërbimin postar, me marrëdhënien ose, të themi, me ndërveprimin ndërkombëtar ose interkonjeksionin e këtyre shërbimeve. Ato aplikohen dhe miratohen, për shkak të faktit se preken shumë nene të secilit prej këtyre dokumenteve, si dokumente të integruara, të cilat në fund të ditës ndoshta nuk parashikojnë ndonjë detyrim për shtetin shqiptar. Pra, nuk ka pasur ndonjë ndryshim në ato çka janë detyrimet e shtetit shqiptar ndaj kësaj organizate, por kanë përmirësuar duke i çuar në një nivel tjetër standardet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ato të aplikueshme në Shqipëri në lidhje me këtë shërbim në vend.

Ju ftojme të na mundësoni miratimin e këtij projektligji të ardhur nga ministria, nga qeveria shqiptare dhe, sigurisht, jemi të hapur për pyetje, duke ju falënderuar në mënyrë të posaçme për vëmendjen!

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Ju falënderoj, zonja zëvendësministre, për shpjegimin shterues dhe seriozitetin!

Ia jap fjalën relatorit, kolegut Krashi.

**Lavdërim Krashi** – Faleminderit!

Në fakt, projektligji që ju keni paraqitur për dhënie mendimi në komisionin tonë kërkon vazhdimësinë e anëtarësisë sonë 100-vjeçare, qysh prej vitit 1922, dhjetë vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Siç e shpjeguat edhe ju, në bazë të nenit 25, se është një procedurë e detyrueshme, pasi në çdo 4 vjet që kjo konventë mban kongreset e saj, jemi të detyruar të vendosim nëse i miratojmë kushtetutën apo krejt bazën tjetër ligjore të kësaj organizate. Ndryshe, nëse nuk shprehim dakordësinë, patjetër që mund ta themi...

Unë do ta vlerësoja ratifikimin ose aprovimin si një mundësi shumë të mirë për ta mbajtur shërbimin e postës shqiptare në një nivel të lartë. Në krahasim me vendet e tjera më të zhvilluara, të mos harrojmë që kur kjo organizatë është stabilizuar fillimisht ose është themeluar, ka pasur vetëm 22 anëtarë, ndërsa sot janë 192 të tillë.

Shqipëria, në fakt, sidomos pas viteve '90, nuk po hyj në historinë e hershme, ka parë një zhvillim shumë të madh të Postës Shqiptare, ka pasur ngritje të nivelit të shërbimit ndaj klientit, duke pasur parasysh se arsyeja kryesore e themelimit të kësaj organizate ka qenë pikërisht mënjanimi i detyrimit për të pasur marrëdhënie individuale me çdo shtet. Kjo është

arsyeja pse janë 192 vende, është pak a shumë e gjithë bota dhe vetëm një ose dy shtete nuk janë anëtare të kësaj organizate.

Kam një sugjerim të drejtpërdrejtë. Ndonëse mund të ketë histori kjo, mund të fillojë që në shekullin e kaluar, unë do të sugjeroja të ketë një përkthim tjetër për shprehjen “bashkimi i përbotshëm postar”, që do të ishte “bashkimi universal postar”. Megjithatë, e kam parasysh që mund të jetë përkthim i shekullit të kaluar. Kështu që do të qëndrojmë me logjikën e asaj kohe.

Thënë sa më lart, u kërkoj të gjithë kolegëve ta ratifikojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Krashi!

Në fakt, me të drejtë, ju ju ngatërrojnë pak gjuha e huaj, kolegj, pasi keni shumë vite që jetoni jashtë. “Universal” është një fjalë e huaj, e huazuar, vjen nga latinishtja, në mos njohuritë e mia linguistike nuk më gabojnë, dhe i përbotshëm është fjalë shqipe. Ndaj, ne nuk duhet të përdorim fjalën “universal”, por “i përbotshëm”. Kështu që përkthimi i citimit është korrekt në marrëveshje.

**Lavdrim Krashi** – Jemi dakord që të mos jemi dakord.

**Mimi Kodheli** – *Agree? Okej*, e kemi kry.

*(Diskutime në sallë)*

Gjysmën e jetës e ka kaluar jashtë, ndaj është normale që i vjen *universal* më thjesht.

Atëherë, vijojmë me pyetje. Kush ka pyetje?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull. Ndoshta pastaj do të pyes kolegun Dule nëse *universal* është fjalë e vjetër greke.

*(Diskutime në sallë)*

Jo? Atëherë, vjen nga latinishtja? Në greqisht është “kozmos”? Ah, atëherë, “universal” është latinisht.

Faleminderit shumë!

E hedhim në votim. Kush është dakord? Shikoj që nuk ka votë kundër, as votë abstenim.

E miratojmë.

Faleminderit, kolegë për bashkëpunimin!

E hedhim në votim nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim edhe në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në rregull. Ju falënderoj, zonja të nderuara!

Punë të mbarë! Faleminderit për prezencën!

Shpresoj të shihemi së shpejti.

Respekte!

**Enkelejda Muçaj** – Shumë faleminderit të gjithëve!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit juve!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 20.04.2022, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”  
(Komision për dhënie mendimi)

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Lavdrim Krrashi, Tritan Shehu, Etilda Gjonaj, Ilirjan Pendavinji, Klodiana Spahiu, Blendi Klosi, Vangjel Dule, Grida Duma dhe Belind Këllici.

**Mungojnë:**

Shpëtim Idrizi, Greta Bardeli, Kreshnik Çollaku dhe Pandeli Majko.

**Të ftuar:**

Adea Pirdeni – Zëvendësministre e Drejtësisë.

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

**Mimi Kodheli** – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është sërish kolegu Xhafaj.

Të ftuar për pikën e tretë dhe të fundit të rendit të ditës kemi rishtazi zonjën Adea Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë, dhe drejtorin Beja.

Mirë se erdhët!

Ju falënderoj për prezencën!

Zonja zëvendësministre, ju lutem, dy fjalë rreth ratifikimit të këtij protokollit.

Faleminderit!

**Adea Pirdeni** – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare e komisionit!

Të nderuar deputetë,

Sot ju paraqitet për shqyrtim projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”, ndryshe “Konventa 108”, e cila, së bashku me protokollin e saj ndryshues, përbën bazën e legjislacionit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për mbi 40 shtete dhe të vetmin instrument ligjor detyrues në nivel ndërkombëtar.

Kjo konventë dhe një prej protokolleve shtesë të saj janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë që prej vitit 2004. Konventa në fjalë, në fakt, është miratuar që në vitin 1981, shumë kohë përpara zhvillimit të mjeteve të reja të komunikimit elektronik.

Epoka dixhitale e dekadave të fundit ka passjellë diversifikimin dhe njëkohësisht intensifikimin e qarkullimit të informacionit me të dhëna personale në mjedisin dixhital, duke e përballur të gjithë sistemin e mbrojtjes së të dhënave personale me sfida të reja.

Qëllimi i protokollit ndryshues ose protokollit nr. 223, të cilin synon të ratifikojë projektligji që ju paraqitet sot për shqyrtim, synon pikërisht përmirësimin e efektivitetit të zbatimit të konventës nr. 108 dhe protokollit shtesë, me qëllim garantimin e një përgjigjeje adekuate ligjore dhe institucionale në drejtim të forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes së kësaj Konvente.

Ky protokoll synon të rrisë ndjeshëm nivelin e mbrojtjes dhe të sigurisë mbi të dhënat personale, si dhe harmonizimin në nivel evropian të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale si një parakusht për qarkullimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet shteteve.

Protokollin ndryshues është hartuar në të njëjtën linjë me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, të miratuar në vitin 2016, në kuadër të akteve ligjore të

miratuara nga BE-ja në këtë fushë, si dhe me direktivën e policisë, me qëllim që palët kontraktuese të mos kenë konflikte me detyrimet që burojnë nga legjislacioni evropian, duke marrë në konsideratë se shumë shtete janë në proces harmonizimi të legjislacionit të tyre të brendshëm me këto akte, përfshirë këtu edhe Republika e Shqipërisë.

Më konkretisht, për dijeni të anëtarëve të nderuar të këtij komisioni, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian është parashikuar përmbyllja brenda këtij viti e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me direktivën e policisë.

Kjo nismë është në përputhje të plotë me rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në terma të përgjithshëm, risitë e këtij projektakti konsistojnë në disa drejtime, kryesisht në shtimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave për të ushtruar kontroll mbi të drejtat e tyre; në zgjerimin e detyrimeve të kontrollit të të dhënave në raport me subjektin; në zgjerimin, gjithashtu, të kategorisë së të dhënave sensitive të përfshira në Konventë.

Është përcaktuar një regjim i saktë i fluksit të të dhënave në nivel ndërkombëtar, si dhe janë sanksionuar kërkesa të forta në lidhje me masën e proporcionalitetit dhe parimet minimizimit të të dhënave, si dhe me ligjshmërinë e përpunimit të tyre.

Me ratifikimin e protokollit ndryshues, Shqipëria i nënshtrohet detyrimit për të lejuar komitetin e konventës të vlerësojë efektivitetin e masave që ka marrë në legjislacionin e brendshëm për të zbatuar dispozitat e konventës tashmë të modernizuara.

Gjithashtu, ngritja dhe forcimi i bazës ligjore do të facilitojë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse për të dhënat personale ndërmjet shteteve anëtare.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim dhe miratim përmban katër nene.

Në nenin 2 të këtij projektligji përcaktohet edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoritet mbikëqyrës dhe jo më thjesht bashkëpunues në kuadër të kësaj konvente.

Në nenin 3 parashikohen shfuqizime të përcaktimeve ligjore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me protokollin ndryshues. Nga pikëpamja procedurale, protokollin ndryshues është miratuar në parim me vendim të Këshillit të Ministrave më 9.12.2020 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i përhershëm në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Europës, natyrisht në përputhje dhe në respektim me të gjithë kuadrin ligjor për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe integrimin e tyre në sistemin juridik të brendshëm.



Ky projektakt ka kaluar përgjatë të gjithë procesit të konsultimit të projektakteve edhe me institucionet e tjera përkatëse.

Së fundi, dëshiroj të rikujtoj se përmes këtij projektligji synohet të zgjerohet sfera e mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo nismë ligjore u përgjigjet, natyrisht, edhe kërkesave bashkëkohore për vigjilencë të shtuar në drejtim të zgjerimit të gamës së të dhënave personale dhe mirëfunksionimit të mekanizmit të mbrojtjes së këtyre të dhënave.

Natyrisht, mbetemi në dispozicionin e anëtarëve të këtij komisioni për të diskutuar çdo çështje e cila do të çmohet me vlerë për këtë diskutim.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Ju falënderoj, zonja zëvendësministre!

Etjen, fjala për ju.

**Etjen Xhafaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja zëvendësministre për prezantimin tuaj!

Edhe një herë, projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale” është vetëm një rishikim i kësaj konvente, e cila bëhet në vazhdimësi. Pra, është një konventë e miratuar goxha herët dhe është konventa më bazike për mbrojtjen e individëve, si dhe që ka lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.

Sic e tha edhe zëvendësministrja, pavarësisht se kjo konventë është miratuar që në vitin 1981, ndryshimet sidomos vitet e fundit dhe sidomos pas vitit 2007 me revolucionin e katërt të teknologjisë, pra me atë që ka sjellë zhvillimin e madh të telefonave dhe ka futur një sërë konceptesh të reja, si interneti i gjërave, *cloud computing* apo përdorimi i të dhënave të mëdha ose *big data*, ka, gjithashtu, edhe një anë tjetër të rishikimeve të herëpashershme që kanë të bëjnë me ato që janë rreziqet, sidomos nga sulmet kibernetike.

Për këtë arsye, ajo që do të thosha unë është se propozimi për këto ndryshime, pra zgjerimi i gamës së informacioneve të cilat konsiderohen sensitive, rritja e nivelit të kontrollit dhe përcaktimi i komisionerit të ruajtjes së të dhënave, si autoritet përgjegjës, është në fakt një ndryshim i cili është një kërcim cilësor përpara dhe që krijon një mundësi shumë të madhe, sidomos sa i përket rritjes së *guard-ës* apo kontrolleve të ruajtjes nga sulmet kibernetike.

Ne kemi parë dje nëpër medie, kjo është raportuar edhe në Komisionin për Sigurinë, por gjithashtu duhet të kemi parasysh që në kohët kur jetojmë, me problemet që janë jo vetëm në rajon, po edhe më gjerë, ku gjithmonë e më tepër si pasojë e revolucionit që po vjen dixhital, atij të 5G-së, dhe të gjitha zgjidhjeve të tjera që do të na lidhin gjithmonë e më tepër

në mënyrë të pakthyeshme me atë që është teknologjia, prandaj besoj që kjo do të ishte një arsye, e cila do të na shtynte të gjithëve të votonim në mbështetje të këtij projektligji, i cili synon rritjen e kontrolleve, rritjen e nivelit të sigurisë dhe, njëkohësisht, ravijëzimin më të qartë të instancave dhe strukturave shtetërore, të cilat janë përgjegjëse për këtë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, koleg!

Ka pyetje? Nëse nuk ka pyetje ose komente, unë mendoj ta hedhim në votim.

Duke ju falënderuar paraprakisht për prezantimin dhe bashkëpunimin, kolegë, kush është dakord me ratifikimin e protokollit ndryshues?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet.

E hedhim në votim nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet me shumicë votash dhe me një votë abstenim.

Neni 2? Faleminderit!

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet edhe në tërësi projektligji, me një votë abstenim.

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Faleminderit, zoti drejtor!

Shumë faleminderit për bashkëpunimin, kolegë!

Shihemi në seancë plenare.

## **MBYLLET MBLEDHJA**